



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA - SUPREME COURT OF KOSOVO

- Për: Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK)
 - Nga: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës
 - Datë: 20 prill 2022
 - Lënda: RAPORT NARRATIV PËR PUNËN E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 1 janar – 31 mars 2022
-


Gjykata Supreme e ka nisur vitin 2022 me 406 lëndë të trashëguara nga viti 2021, ndërkaq, tre-mujori i parë i vitit 2022 është përmbyllur me 789 lëndë në punë, prej tyre të pranuar 383 lëndë të reja, ndërkaq të zgjidhura në këtë periudhë raportuese rezultojnë 301 lëndë.

Rrjedh se muaji prill e ka gjetur Gjykatën Supreme me 488 lëndë të pakryera, në të cilat, numrin më të madh e përbëjnë revizionet - R - me 315 lëndë të pakryera, pasuar nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë - PML me 83 sosh dhe revizionet ekonomike - RE- me 79 lëndë të pakryera.

Të kalkuluar në përqindje, kemi grafikonin në vijim:

RAPORTI TREMUJOR


■ Të trashguara ■ Një punë ■ Të pranuar ■ Të kryera ■ Të pakryera



1. Raport i tremujorit të I-rë, të punës së Gj.Supreme, shprehur në përqindje

Ndërkaq, në tabelën më poshtë, janë listuar lëndët e zgjidhura gjatë kësaj periudhe, që përfshin, 159 revizione, 69 kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë - PML, 32 kërkesa për zbutje të dënimit - PZD, 16 kërkesa administrative për rishqyrtim të jashtëzakonshëm juridik - ARJ, ..


Lloji i lëndëve të kryera



2. Ndërja e lëndëve të kryera, sipas kërkesave të pranuar

Nga data 1 mars, Gjykatës Supreme i janë shtuar tre gjyqtarë të rinj, dy në degën civile ndërkaq njëri në Kolegjin e Apelit për ankesa ndaj vendimeve të Agjencisë Kosovare të Pronës (KKP dhe KVVP). Ky numër i gjyqtarëve në degën civile, pritet të ndikojë edhe në efikasitetin e Gjykatës Supreme, lidhur me zgjidhjen e lëndëve. Ndërkohë që një gjyqtare e kësaj dege, do të dal në pension gjatë muajit prill.

E kalkuluar në përqindje, shkalla e efikasitetit në zgjidhje të lëndëve, del të jetë 78.59 për qind, duke llogaritur numrin e lëndëve të pranuar dhe atyre të zgjidhura, gjatë periudhës raportuese.



3. Shkalla e efikasitetit në zgjidhje të lëndëve 78.59 për qind

Nga muaji mars, Gjykata Supreme ka filluar me shpërndarjen automatike të lëndëve përmes sistemit SMIL, proces ky që po zhvillohet me asistimin e IT-ve të gjykatës.

Ndërkaq, lidhur me publikimin e aktgjykimeve dhe aktvendimeve të Gjykatës Supreme, gjatë tre muajve të parë të vitit 2022, janë publikuar 828 aktgjykime dhe aktvendime, 566 prej tyre vendime të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Po ashtu, janë publikuar dy vendime të kryetarit të Gjykatës, lidhur me ankesat disiplinore.



4. Gjatë tremujorit të I-rë, janë publikuar 828 vendime

Gjykata Supreme, në periudhën raportuese ka mbajtur një Seancë të Përgjithshme (16 shkurt 2022), gjatë të cilës është diskutuar rreth raportit vjetor të punës së Gjykatës, për vitin 2021 si dhe për planin dhe programin e gjykatës për vitin 2022. Po ashtu, në këtë seancë është miratuar ky plan, përfshirë orarin vjetor të punës dhe caktimin e kolegjeve.